



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4803/2 /prot.

Himarë, më 23.06. 2025

**NJOFTIM**

**Lënda :** Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Himarë.

Të nderuar këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e premte më datë 27.06.2025, ora 10: 30 ,në sallën “ Neço Muko” Himarë do të zhvillohet mbledhja e radhës për muajin qershor e Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të pikës 4, neni 53, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Mbledhja do të ketë rend dite.

- Miratimi i rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026 - 2028 ”.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për dhënien e miratimit në parim , për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqeje prej 1 ha , Nr.pasurie 2/78 , ZK:3844 në favor të shoqërisë “Soleil & Sea”, SH.P.K.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për dhënien e miratimit në parim , për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqeje prej 1.74 ha në ekonominë pyjore “mali i Pilurit , Çikë” , ngastra 69 , ZK: 3813 në favor të z.Bardhosh Çeloleskaj”.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për dhënien e miratimit në parim , për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqeje prej 20.922 ha në Palasë , ZK: 2863 në favor të shoqërisë “ Dulla Konstruktion”, SH.P.K.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Mbi transferimin në pronësi të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës – Kanalizimeve Vlorë , ujësjellësi Bolenë, ujësjellësi Kuç, ujësjellësi Kallarë , impiant i trajtimit të ujërave të ndotura”.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Mbi transferimin kapital pa pagesë të aseteve me objekt “ Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm të zonave turistike , Dhërmi , Gjilekë , Kondraq dhe Palasë , në administrim Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve , Vlorë Sh.A.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e marrjes me qëra të një ambienti për tu përdorur si magazinë e ndërmarrjes të shërbimeve publike”
8. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1- 31 maj , nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok – ndihmës ekonomike”.
9. Të ndryshme.

Sekretari

Elena Memushaj

